



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.9, datë 30/05/2023

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES  
NR.SERIE 0005, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.6, DATË  
07.02.2018 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,  
SUBJEKTIT “HAKO” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Ishëm,

**V E N D O S I:**

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 0005, miratuar me Vendimin Nr.6, datë 7.02.2018 të Këshillit të Basenit Ujqor Ishëm-Erzen si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X=4396200; Y=4580250; Z=62.3m.m.n.d(ALBANIAN 1986/GK4)

Në: X=4395923; Y=4580538; Z=62.3m.m.n.d(ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=479479; Y=4579687; Z= 62.3 m.m.n.d (KRGJSH)

- Sasia e ujit që jepet në përdorim:  $Q=0.0013$  l/s
  - Prurja mesatare :  $Q_{mes}= 2$  l/s
  - Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike
2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 0005, miratuar me Vendimin Nr.6, datë 07.02.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen, “leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për ujë teknologjik (prodhim i produkteve të mishit)”, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, Kashar, Bashkia Tiranë.
  3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

